

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Albert Zogaj, kryetar i kolegjit, Isa Kelmendi dhe Gëzim Lulluni, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Q.V., nga fshati ... Komuna e Gjakovës, të cilin e përfaqëson i autorizuari B.B., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Inspektorati Policor i Kosovës në Prishtinë, të cilin e përfaqëson Sh.H. sipas autorizimit për shkak të anulimit të vendimit për largim nga puna dhe kthimin në punë, duke vendosur sipas ankesës së të autorizuarit të t'paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.3021/13, i datës 05.12.2014, në seancën jo publike të mbajtur me datë 06.06.2016, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të autorizuarit të t'paditurës Inspektorati Policor i Kosovës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.3021/13, i datës 05.12.2014, VËRTETOHET në pikën I (një) të dispozitivit që ka të bëjë me anulimin e vendimit të kryeshefit ekzekutiv të Inspektoratit Policor të Kosovës në Prishtinë, Nr.01-283 i datës 16.08.2013, dhe vendimit të komisionit të ankesave me të cilin paditësit i është shqiptuar masa disiplinore largim nga puna Nr.002/IPK-KA-2013, i datës 18.10.2013, dhe në pikën II (dy) të dispozitivit në pjesën me të cilën është detyruar e paditura që paditësin ta kthejë në vendin e punës.

II. APROVOHET pjesërisht e bazuar ankesa e të autorizuarit të t'paditurës Inspektorati Policor i Kosovës, ndërsa PRISHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.3021/13, i datës 05.12.2014, në pikën II të dispozitivit në pjesën e kërkesëpadisë me të cilën e paditura është detyruar që paditësit t'ia njoh të gjitha të drejtat dhe detyrimet që kanë ekzistuar para largimit nga puna duke përfshirë pagesën e pagës, pagesën e shujtës, shfrytëzimin e pushimit si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore dhe për këtë pjesë lënda i kthehet gjykatës se shkallës së parë në rishqyrtim dhe vendosje.

## A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.3021/13, i datës 05.12.2014, në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit Q.V., nga Prishtina, dhe e ka anuluar si jo ligjore vendimin e kryeshefit ekzekutiv të Inspektoratit Policor të Kosovës në Prishtinë, Nr.01-283 i datës 16.08.2013, si dhe vendimi i komisionit të ankesave me të cilin paditësit i është shqiptuar masa disiplinore largim nga puna te Inspektorati Policor i Kosovës Nr.002/IPK-KA-2013 i datës 18.10.2013, (me numër protokolli 03-308 i datës 18.10.2013).

Në pikën II të dispozitivit ka vendosur që të detyrohet e paditura Inspektorati Policor i Kosovës në Prishtinë, që paditësin ta kthejë në vendin e punës me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që kanë ekzistuar para largimit nga puna siç janë: pagesa e pagës, pagesa e shujtës, shfrytëzimit të ushqimit si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 374 Euro, të gjitha në afat prej 7 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Kundër këtij aktgjykimi i autorizuari i të paditurës në afat ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet e bazuar ankesa e të autorizuarit të paditurës ndërsa aktgjykimi i atakuar të priset dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe vendosje ose aktgjykimi i atakuar të ndryshohet ashtu që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pa bazuar.

Ankesa e të autorizuarit të paditurës i është dorëzuar të autorizuarit të paditësit por i njëjti nuk ka dhënë përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të autorizuarit të paditurës është pjesërisht e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi përmes të autorizuarit të tij me datë 19.11.2013, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, ka paraqitur padi kundër të paditurës Inspektorati Policor i Kosovës të cilën e ka precizuar në seancën përgatitore të datës 05.11.2014, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi i kryeshefit ekzekutiv të IPK-së Nr. 01-283, i datës 16.08.2013, si dhe vendimi i komisionit të ankesave Nr.002/IPK-Ka-2013, i datës 18.10.2013, me të cilin paditësit i është shqiptuar masa largim nga puna si dhe të detyrohet e paditura që në afat prej 8 ditësh nga marrja e vendimit paditësin ta kthejë në vendin e punës me të gjitha të drejtat dhe detyrat e punës që kanë ekzistuar para largimit të tij nga puna duke përfshirë pagesën e pagës, pagesën e shujtës, pagesën e shfrytëzimit të pushimit si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore të gjitha këto në afat prej 8 ditësh nga dita e marrjes së këtij vendimi.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të prezantuara nga palët ndërgjyqëse, në seancë të shqyrtimit kryesor ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.3021/13, i datës 05.12.2014, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimin gjykata ka theksuar se në mes të palëve nuk ka qenë kontestuese fakti se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura. E paditura me vendimin numër.03-262 të datës 02.08.2013, e ka formuar Komisionin Disiplinor në përbërje prej 3 anëtarëve A.T., V.O. dhe M.K., për shqyrtimin e shkeljeve të mundshme disiplinore nga Q.V. dhe B.H.. Paditësit me vendimin e krye shefit ekzekutiv të paditurës nr.03-252, i datës 19.07.2013, është suspenduar nga puna me pagesë. Komisioni Disiplinor i të paditurës me vendimin nr.03-70, i datës 16.08.2013, paditësit i ka shqiptuar masën disiplinore largim nga puna.

Ketë vendim e ka miratuar kryeshefi ekzekutiv me vendimin Nr.01-283, i datës 16.08.2013, me të cilin paditësit i është shqiptuar masë e rëndë disiplinore largim nga puna në vendin e punës hetues në Departamentin e Hetimeve në Inspektoratin Policor të Kosovës. Kundër këtij vendimi paditësi brenda afatit ligjor paraqet ankesë pranë komisionit të ankesave të t'paditurës.

Komisioni i Ankesave i të paditurës me vendimin e saj numër 002/IPK-KA-2013, i datës 18.10.2013, e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e paditësit ndërsa vendimin e kryeshefit ekzekutiv të IPK-së, e ka lënë në fuqi. Gjykata ka vlerësuar se vendimi i kryeshefit ekzekutiv të IPK-së, Nr.01-283, i datës 16.08.2013, me të cilin është aprovuar vendimi i komisionit disiplinor është jo ligjor për shkak se në rastin konkret nuk janë përfillur procedurat e lartcekura nga e paditura ngase anëtare e komisionit disiplinor lidhur me vendimin për përjashtimin nga puna ka qenë V.O. e cila po ashtu ka qenë e përfshirë me rastin e inicimit të procedurës dhe njëkohësisht është edhe dëshmitare e këtij rasti.

Sipas dispozitës së nenit 26 paragrafi 6 të Udhëzimit Administrativ 2003/04 është paraparë se komisioni disiplinor përgatit raport përfundimtar dhe merr vendim lidhur me masën disiplinore, ndërsa kundër këtij vendimi pala ka të drejtë në ankesë në komisionin e ankesave pranë të paditurës kurse në rastin konkret kryeshefi ekzekutiv me vendimin e tij e ka aprovuar vendimin e komisionit disiplinor me të cilin paditësit i është shqiptuar masa disiplinore largim nga puna me çka ka bërë shkelje të këtyre dispozitave. Gjykata ka shtuar se e paditura gjatë zhvillimit të procedurës disiplinore ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 36 paragrafi 6 të Udhëzimit Administrativ nr.13/MPB-2011, i cili përcakton se për shkeljet e rënda disiplinore Komisioni disiplinor përgatit raport përfundimtar dhe merr vendim për dhënien e masës disiplinore, e po ashtu edhe shkelje të nenit 38 paragrafi 4 i cili përcakton se punonjësi ka të drejtë të mbrohet nga ndonjë punonjës tjetër si mbrojtës i tij i cili merr pjesë në seancat e shqyrtimit të ankesës andaj në rastin konkret paditësi as mbrojtësi i tij nuk janë ftuar që të marrin pjesë në seancën e shqyrtimit të ankesës. Lidhur me mënyrën e vendosjes sa i përket bazës juridike u bazua në dispozitat e nenit 78 dhe 79 të Ligjit të Punës, ndërsa lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore u bazuar në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë në pjesën e dispozitivit e cila me aktgjykimin e Gjykatës se Apelit është vërtetuar (pika I e këtij aktgjykimi) është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Pretendimet e ankuesit se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n), e LPK-së, nuk qëndrojnë sepse aktgjykimi i ankimuar nuk ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohet e në lidhshmëri me këtë as dispozitivi i aktgjykimit nuk është kontradiktor në raport me arsyet e aktgjykimit.

Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat kanë përcaktuar edhe vendosjen meritore të kërkesëpadisë. Ankuesi më tepër ka bërë përshkrimin e përmbajtjes së dispozitës së nenit 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së, se sa që ka dhënë arsye apo shpjegime se është i përfshirë aktgjykimi në këtë shkelje, prandaj Gjykata e Apelit, nuk është lëshuar në arsyetim të mëtejshëm pasi që nuk ka mundur të supozoj se cilat janë pretendimet konkrete të ankuesit për këtë pikë.

Përkitazi me pretendimet e ankuesit për shkelje për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, duke i provuar kështu të gjitha faktet vendimtare të çështjes me çka ka krijuar një figurë të qartë të gjendjes faktike nga e cila pastaj në përputhje me normat e të drejtës materiale ka nxjerrë përfundimin për themelësinë e kërkesëpadisë.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se një numër relativisht i madh i fakteve të çështjes kanë qenë jokontestuese, por edhe janë provuar me provat e administruara në shqyrtimin kryesor. Pretendimet ankimore për gjendjen faktike më tepër i referohen vlerësimit që ka bërë gjykata e shkallës së parë përkitazi me ligjshmërinë e vendimeve të marra nga e paditura në procedurën disiplinore sipas gjendjes faktike të konstatuar në shqyrtimin kryesor. Në këtë kontekst gjykata e shkallës së parë me provat e administruara ka sqaruar faktet vendimtare të çështjes në mënyrë të kujdesshme duke dhënë vlerësime adekuate për fuqinë provuese të secilës provë dhe rrjedhimisht të secilit fakt për mënyrën se si gjykata i ka kualifikuar në raport me normën materialo-juridike. Gjykata e Apelit nuk i ka pranuar pretendimet për këtë shkak ankimor pasi që siç u theksua edhe me lart këto pretendime kanë të bëjnë me vlerësimet e të paditurës, përkatësisht organeve të t'paditurës për vlerësimin që ka bërë e paditura përkitazi me veprime e paditësit që sipas të paditurës këto veprime kanë konsumuar elemente e shkeljeve disiplinore për të cilat janë shqiptuar masat disiplinore me vendimet e atakuar, ligjshmërinë e të cilave e ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë.

E drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë nga gjykata e shkallës së parë dhe në këtë pikë Gjykata e Apelit e pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm përfundimin e gjykatës së shkallës së parë duke shtuar se në çdo rast procedura disiplinore duhet të zhvillohet duke respektuar me korrektësi dispozitat formale në mënyrë që në atë procedurë të vlerësohet në mënyrë objektive dhe me siguri të plotë juridike shkelja e mundshme disiplinore nga punonjësi.

Gjykata e shkallës së parë më të drejtë ka gjetur se në rastin konkret në procedurë disiplinore tek e paditura janë bërë shkelje të procedurës pasi që njëri anëtar i komisionit nuk është dashtë të jetë pjesë e komisionit për shkak se pjesëmarrja e tij/saj konsumon elementet e konfliktit të interesit të paracaktuar me Udhëzimin Administrativ nr.13/MPB-2011 dispozita e nenit 26 paragrafi 4, të shtojcës F të Udhëzimit Administrativ me Nr. MSHB/DASH 2003/04, dispozita 10 paragrafi 3.

Për më tepër Gjykata e Apelit thekson se në çdo rast kur zhvillohet procedura disiplinore duhet të garantohet objektiviteti i shqyrtimit të shkeljes së mundshme nga ana e punonjësit, ndërsa për tu garantuar ligjshmëria e procedurës disiplinore dhe objektiviteti, kushti i parë është që të ketë organ përkatës me kompetencë për zhvillimin e procedurës e në lidhshmëri me këtë përbërja e organit kompetentë të jetë e tillë që garanton një proces disiplinor të ligjshëm.

Në këtë kontekst rezulton se duhet të plotësohen në mënyrë kumulative disa kushte për largimin e punonjësit nga puna apo për shqiptimin e cilës do masë disiplinore dhe ato janë: veprimet e punonjësit të kualifikohen si veprime që përbëjnë shkelje, masat disiplinore të jenë në përputhje me natyrën e shkeljes dhe procedura të zhvillohet sipas rregullave për zhvillimin e procedurës disiplinore. Në rastin konkret vlerësimi i gjykatës së shkallës së parë ishte se procedura është përcjellë me mangësi përkatësisht me shkelje për shkak të përbërjes joadekuate të komisionit disiplinor, vlerësim të cilin e ka pranuar edhe Gjykata e Apelit. Qëllimi i procedurës disiplinore është që pas shqyrtimit të fakteve përkitazi me shkeljen e mundshme të përcaktohet nëse veprimet apo mos veprimet e punonjësit përbëjnë shkelje, por këtë vlerësim komisioni përkatës duhet ta krijoj gjatë procedurës duke shqyrtuar dhe vlerësuar faktet e prezantuara nga punëdhënësi dhe punonjësi, e në asnjë mënyrë nuk lejohet që komisioni apo anëtarët e komisionit të japin vlerësim të paracaktuar siç ka ndodh në rastin konkret. Është potencialisht e pamundshme dhe e pabesueshme që të pritet vlerësim objektiv nga komisioni apo anëtarët e komisionit të cilët na paraqitën edhe si iniciues të procedurës disiplinore, si dëshmitar në procedurën disiplinore dhe si anëtar të komisionit.

Gjykata e Apelit është mjaftuar me gjetjet e gjykatës së shkallës së parë për gabimet formale të t'paditurës në procedurën disiplinore, për ti konsideruar si të kundërligjshme vendimet e të paditurës në atë procedurë dhe nuk është lëshuar në pranueshmërinë dhe besueshmërinë e disa provave e të cilat janë përdorë në procedurën disiplinore nga ana e të paditurës ndaj paditësit (siç janë disa foto dhe dëgjimi i një dëshmitareje), por për nevoja të praktikës gjyqësore thekson se gjykata e shkallës së parë ka mundur ti vlerësoj me mosbesim edhe këto prova për shkak mënyrës se si janë siguruar nga e paditura.

Aktgjykimi i shkallës së parë në pjesën që është prishë dhe është kthyer në rishqyrtim sipas pikës II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së, pasi që dispozitivi i aktgjykimit në këtë pjesë është i paqartë dhe në kundërshtim me arsyet e aktgjykimit, meqenëse nuk përcakton në mënyrë konkrete sa është lartësia e pagës së gjykuar, sa është lartësia e shujtës dhe të drejtave të tjera e në lidhshmëri me këtë as nuk janë dhënë arsyet për këtë vendosje. Vendimi për shpenzimet po ashtu është prishur sepse shpenzimet duhet të gjykohen në mënyrë unike për të gjitha veprimet dhe për tërë procedurën.

Për pjesën e kthyer në rigjykim udhëzohet gjykata e shkallës së parë që në riprocedurë të vërtetojë faktin se sa është lartësia e pagës dhe detyrimet tjera, nëse është kontestuese lartësia atëherë me prova përkatës-ekspertizë të vërtetojë lartësinë dhe pas administrimit edhe të provave tjera në shkresat e lëndës të marrë vendim të ligjshëm.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) dhe pika (c) e LPK-së.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

Ac.nr. 1083/15, me datë 06.06.2016

Kryetari i kolegjit  
Albert Zogaj, d.v